



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 462/01-6025 dt. 08/02 2022

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Aktgjykimit C.nr.97/86, të datës 06.10.1988, Propozimeve për lokacion Nr.01-070/01-5689, të datës 07.02.2022, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të aprovoi këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për caktimin e lokacioneve për zbatimin e Aktgjykimit C.nr.97/86, të datës 06.10.1988

I

Më këtë propozim vendim lejohet caktimi i lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C.nr.97/86, të datës 06.10.1988, ku i është njohur e drejta e pronës Istref Heta nga Gllogoci, në sipërfaqe prej 0.19 ha në zonen kadastrale Çikatovë e Re.

II

Komisioni për dhënien e tri (3) propozimeve për zbatimin e Aktgjykimit C.nr.97/86, të datës 06.10.1988, i ka propozuar ngastrat kadastrale si më poshtë:

- Propozimi i parë është në zonën kadastrale në Çikatovë e Re, në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.140-2, me S=0.19 ha, me kulturë- kullosë, kl. 2.
- Propozimi i dytë është në zonën kadastrale në Çikatovë e Re, në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.286-0, pjesa e propozuar e sipërfaqes S=0.19 ha, me kulturë- kullosë, kl. 1.
- Propozimi i tretë është në zonën kadastrale në Çikatovë e Re, në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.326-4, pjesa e propozuar e sipërfaqes S=0.19 ha, me kulturë- kullosë, kl. 1.

Për kevend u terbjekë nga autoritet e KPE-së

III

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin pranë këtij organi.

IV

Pjesë e këtij propozim vendimi janë: Aktgjykimi C.nr.97/86, i datës 06.10.1988, Aktgjykimi C.nr.175/89, i datës 14.07.1989, Fletat Poseduese, lokacionet me koordinata, propozimi për caktimin e lokacioneve nr.01-070/01-5689, i datës 07.02.2022.

V

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



A r s y e t i m


Komuna e Drenasit me qëllim të zbatimit të Aktgjykimit C.nr.97/86, të datës 06.10.1988, i propozon kuvendit të komunës së Drenasit caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit të lartcekur, ku i është njohur e drejta e pronës Istref Heta nga Glogoci, në sipërfaqe prej 0.19 ha në zonën kadastrale Çikatovë e Re.

Pasi që me aktgjykimin e lartcekur, ju është njohur e drejta e pronës në z. Istref Heta në sipërfaqe prej 0.19 ha, në parcelën 118/0, në zonën kadastrale Çikatovë e Re, e cila parcelë është futur nën masën komosative dhe për këtë arsye është e pamundur që të zbatohet Aktgjykimi C.nr.97/86, të datës 06.10.1988, prandaj Komuna e Drenasit me qëllim të realizimit të së drejtës së pronës, si dhe zbatimit të Aktgjykimit ka caktuar komisionin për dhënien e propozimeve për zbatimin e aktgjykimit, njëkohësisht vendosjen e ligjshmërisë lidhur me këtë çështje.

Komuna e Drenasit në rastin konkret ta ndërmarr të gjitha procedurat e nevojshme, duke e dërguar për aprovim këtë propozim vendim në Kuvendin e Komunës së Drenasit si organ i vetëm i cili menaxhon me pronat komunale.

Me respekt!

KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Prahuar		07.02	2022
Nj. Org	Namër	Proje	Vlera
01-070/01-5689			



Data:	07.02.2022
Për:	Komuna e Drenasit, Kryetar Ramiz Lladrovci
Nga:	Komisioni : Fadil Tahiri Defrim Nika Besart Bajrami
Lënda:	Propozimet për lokacione në zbatim të Aktgjykimit C.nr.97/86

Me Vendim të kryetarit të komunës z.Lladrovci nr.020/04-2661 dt. 18.01.2022 me të cilin është formuar komisioni në përbërje : Fadil Tahiri , Defrim Nika dhe Besart Bajrami nga i cili kërkohet zbatimi mbi bazën e Aktgjykimit të formës së prerë Gjykatës Komunale në Glllogoc C.nr.97/86 dt:06.08.1988 i cili është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.175/89 i dt.14.07.1989 i cili përfaqëson dokument juridik për fitimin e pronësisë dhe regjistrimin e pronësisë në palujtshmërinë e përshkruar në dispozitivin e aktgjytimeve të formës së prerë.

Nga komisioni është kërkuar të propozohen tri lokacione respektivisht pjesë të parcelave në zonën kadastrale Çikatovë e Re të cilat propozime do t'i dorëzohen kryetarit z. Lladrovci cilat do të procedohen në Kuvendin e Komunës së Drenasit për aprovim.

Komisioni propozon :

Pasi që parcelat duhet të jenë mbrenda zonës kadastrale Çikatova e Re dhe sipërfaqja e parcelës duhet të jetë 1900 m² ne kemi shqyrtuar pronat e komunës së Drenasit në tri lokacione të mundshme nga të cilat kemi zgjedhë si propozime me sa vijon:

Lokacioni nr.1 parcela 140-2 në sipërfaqe 1900 m²



Koordinatat e lokacionit:

Pika	y	x
1	7489961.948	4721602.975
2	7489999.948	4721587.419
3	7489988.975	4721556.328
4	7489982.084	4721534.433
5	7489953.249	4721556.298


Lokacioni nr.2 pjesë e parcelës 286-0 në sipërfaqe $S=1900 \text{ m}^2$



Koordinatat e lokacionit:

Pika	y	x
1	7490131.056	4720649.192
2	7490108.739	4720603.32
3	7490074.882	4720655.708
4	7490085.638	4720673.648

Lokacioni nr.3 pjesë e parcelës 326-4 në sipërfaqe S=1900 m²



Koordinatat e lokacionit:

Pika	y	x
1	7490191.262	4720615.402
2	7490165.794	4720630.666
3	7490132.565	4720578.724
4	7490145.146	4720568.928
5	7490153.75	4720557.335



Republika e Kosovës

Republica Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živine Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315052-00286-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

01-070/015689

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

08.02.2022 - 15:32

Komuna / Opština / Municipality:

GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Çikatojë E Re / Novo Çikatojë / Çikatojë E Re

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315052-00286-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		7986			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostil adrese Address particulars	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FSHAT-LEDINË/FSHAT-LEDINË/FSHAT-LEDINË				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/pojtopritivredno/Agriculture	Kulllosar/Pashnjaci/pasture	Kulllosë E Klasës I/Pashnjak I Klasse/1st Class Pasture	7986

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenç broj ID. No.	Vendbanimi Prehivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Dezavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC /		FEHMI DHE XHEVE LLADROVCI	1/1		



Azyrtari pergjeter i Qeverornio lice / Official person



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315052-00326-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 01-070/015689
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 08.02.2022 - 15:31
Komuna / Opština / Municipality: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çikatovë E Re / Novo Çikatovo / Çikatovë E Re
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70315052-00326-4	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	42991	Sipas kërkes se terreni me nr.942-942-10548 me dt. 20.07.2017 gjelodeti Safet Hoxhal4-2004	12.02.2018	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostil adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
FSHAT-LEDINË/FSHAT-LEDINË/FSHAT-LEDINË			12.02.2018	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i Klasesë Kvalitet Klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²) (m ²)
1	Buyqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pashnjak/pasture	Kullosë E Klasesë 1/Pashnjak 1 Klase/1st Class Pasture	42991

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GILLOGOC / GLOGOVAC / GILLOGOC /		FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI	1/1	14-2004	12.02.2018





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedistit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315052-00140-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

01-070/015689
08.02.2022 - 15:32
GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC
Çikatojë E Re / Novo Çikatojë / Çikatojë E Re
GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315052-00140-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	1900		31.12.2014	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
UTRINA-SELO/UTRINA-SELO/UTRINA-SELO			31.12.2014	



A.2 LLOJII I SHRYTYTZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²)
2	Bujqësori/Pojopritvredno/Agriculture	Kullosat/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 2/Pashnjak 2 Klasse/2nd Class Pasture	1900

B. PRONARI/POSEDEUESI - VLASNIK/DRZALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GILLOGOC / GLOGOVAC / GILLOGOC /		FEHMI DHE XHEVË LADROVCI	1/1	Sipas kërkesës për veprim nr 01In070/01-1888 data 13.01.2022 ,qertifikata e pronës data 13.01.2022 ,Që anulohet Aktvendimi nr 560/2014 data 29.12.2014	14.01.2022



NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA KOMUNALE NE GLOGOVCI, si gjykate civile, me gjyqtar Jasna Periqi si gjyqtar individual, ne qeshtjen juridike te paditesit Istref B. Heta nga Glogovci, kunder te paditures Komuna e Glogovcit, e lidhur me vertetimin e pronesise, vlera e kontestit 25.000.-din, seances verbale dhe shqyrtimit kryesor te mbajtur me 6.10.1988, muar kete:

A K T E J K I M

I. APROVCHET ne tersi kerkesepadia e palese paditese si e bazuar, dhe vertetohet se paditesit Istref B. Heta nga Glogovci, e pronare ne baze te posedimit te pjeses jugore te ngastres nr.118 me kultur kullos te klasit te dyte ne siperfaqe prej 0.19,00 ha, ne vitin e quajtur "Fshate-Kryeqesta" KK. Qikatov e Re, e cila shtrihet ne veri ne gjatesi prej 19,6m dhe kufizohet me ngastren nr.118 ne prone shoqerore nga ana lindor ne gjatesi prej 101 metra, per gjate ngastres se paditesit nr.108/2, nga ana jugore ne gjatesi prej 18,1 m, me rruged publike ndersa nga ana perendimore ne gjatesi prej 101 m, me ngastren nr.119 prone e Abaz L. Qorrit, andaj e paditura Komuna e Glogovcit, obligohet qe ti njohe kete te drejte.

II. E Paditura eshte e obliguar qe paditesit te paguaj shume prej 23.500 din. ne emer te shpenzimeve procedurale te ketaje konteste ne afate prej 15 ditesh, nen kercenimin e permbarrimit me dhune.

A r s y e t i m

Paditesit me padi dhe gjate shqyrtimit ka theksuar se eshte pronare dhe posedues i ngastres se pershkruar me larte ne baze te posedimit, se te njejten ngastren babaje i tije e ka blere ne vitin nga pronari Vela Vujaqiqi dhe se te njejten siperfaqe e shfrytezon are prej atehere e gjere sote. Ka theksuar se siperfaqja kontestuese rastin e ajrofotografimit eshte e evidencuar si prone shoqerore, ndaj ajo nuk i ka vendosur guret, dhe se ne fjalen e vete perfundimtare propozuar qe Gjykata e aprovoj kerkesepadin sipas mendimit dhe kontestimit te ekspertit. Shpenzimet e ka kerkuar dhe i ka percaktuar.

Perfaqesuesi i te paditures ka kontestuar ne tersi kerkese duke theksuar se siperfaqja kontestuese evidentohet si prone shoqerore ne baze te fletes poseduse nr.74 KK Qikatov e Re, dhe ka propozuar Gjykata kerkesepadin ta refuzoi si te pabazuar. Shpenzimet i ka kerkuar te paguaj.

Gjykata ka nxjerrur te gjitha procat e propozuar dhe duke i vlersuar te njejtat ne veshtrim te nenit 8 te LPC ka gjetur se ka padi e paditesit ne tersi eshte e bazuar nga keto arsye:

Gjykata ka administruar provat me daljen e Gjykates ne vend ngjarjese me ekspertin -gjeometrin Gjafer Ramaj nga Glogovci, dhe vrojtim te drejteperdrejte ne vende te ngjarjese ka vertetuar se ne pjesen e siperfaqese gjendet rruga ndersa pjesa tjeter e mbledhur mizer, ndersa me identifikimin nga ana e ekspertit -gjeometrit, te cili e ka dhene ne baze te konstataimit dhe mendimit eshte vertetuar se are per te cilen paditesit kerkone qe ti njihete e drojta pronesore pjesen e ngastres 118 ne siperfaqe te tersishme prej 0.50,00 ha, me kultur kullose e klasit te dyte ne vendin e quajtur "Fshate-Kryeqesta" KK. Qikatove e Re, evidentuar ne fleten poseduse nr.74 si prone shoqerore dhe ne baze te dimenzjoneve te dhena ne kopjen e planit ne siperfaqe prej 0.19 ha.

Ne baze te katastrit pershkruese dhe fletes poseduse nr.32 KK.Qikatove e Re,Vela Vujaqiqi ka patur siperfaqen e tersishme prej 5.58 ha, andaj si pronare kete siperfaqe ua ka shitur personave tjere para vitit 1961(para ajrofotografimit) dhe ate siperfaqen prej 5.40,44 ha, ku shihete diferenca ne siperfaqet sipas katastrit pershkruese dhe pase ajrofotografimit ne vitin 1961 ,dhe ate diferenca prej 0.17,56 ha, me vrejte se pase ajrofotografimit rralle here siperfaqet ka qene ne tersi te perputhura ,nga se katastri pershkruese eshte matje e perferme, andaj duke krahasuar diferencen ne mese siperfaqese te cilen e ka patur Vela Vujaqiqi dhe siperfaqen te cilen e ka shitur shifet se perafersisht siperfaqja eshte e njejte , te cilen e kontestaditesit.Ka theksuar se ngastren nr.118 para ajrofotografimit ka egzistuar nje puse dhe shtalla, qe provone se e njejta ngaster ka qene ne prone private ,por per shkak te rrethanave dhe mose percaktimit nga e paditesit e njejta ngaster evidentuar si prone shoqerore .

Gjykata teri ka aprovuar konstatimin dhe mendimin e eksperti nga se injejt i eshte profesjalisht i ngritur dhe e disponune me preaditje dhe dituri te nevojshme , dhe se mendimin dhe konstatimin e kadhene ne baze te vrojtimit te drejteperdrejt ne vende te ngjarjes dhe ne baze te skicave ,nderesa palete kete nuk e kane kontestuar.

Pastaj Gjykata ka administruar provate me shiqimin e shkrones zyrtare te Drejtoris Gjeodete ne Glogoc, dhe ne baze te saje ka vertetuar se Vela Vujaqiqi sipas katastrit pershkruese sipas fletes posedus nr32 ,gjendja nga vitit 1957, eshte pronare i palujtshmerie ne siperfaqe prej 5.58 ha, ne vandin e quajtur "Fshat-Kryqesta" e du shiquar foteskicen nga viti 1986 Vela Vujaqiqi ne baze te ajrofotografimit nuk posedon kurfare pasurije nga se i njejt i kete e ka shitur rrethe viteve 1957/60 dhe ate ne siperfaqe prej 5.40,44 ha, ne vendi e lartepemendur ,anfaj si perfundim i katyre provave rrjedhe se siperfaqja e palujtshmerise sipas katastrit pershkruese prej 5.58 ha , eshte me e madhe se sa siperfaqja qe ajo e ka shitur qe arrine 5.40,44 ha,diferenca prej 0.17,54 ha ,ka mbetur pa evidentuar me rastin e ajrofotografimit si prone shoqerore .

Gjykata ne tersi ka aprovuar proven e tille me shkrim, nga se eshte bere nga personat profesjonist dhe sipas shenimeve pozitive me te cilat disponon DGJK ,e cila ne tersi perputhet me mendimin dhe konstatimin e ekspertit ,te cilit gjykata ja ka falur besimin.

Deshmitari Mrika Vujaqiqi i vili ne tersi ka vertetuar them e paditesit,ka theksuar se eshte e vertete se babaje i tije Vela Vujaqiqi e ka shitur ngastren kontestuse me 1958 babajet te paditesit dhe ate ne baze te kontrates gojore, andaje i njejt i kete e ka shfrytezuar si are qe me se 20 vite,dhe ne ka ditur se toka eshte prone shoqerore nga viti 1961 ,me rastin e bartjese se pronesise andaj ka theksuar marveshja rrethe tokes ka qene i atille siqe e ka pershkruar paditesit

~~Gjykata~~ deshmitari Smajl Meta gjithashtu ka theksuar se i eshte e njohur se babaje i paditesit e ka blere toka nga padia ,prej pronarit Vela Vujaqiqit ne vitin 1958 nga se babajet te paditesit e ka pasur mixhe dhe nga ketu ishte njohur se babaje i paditesit e ka shfrytezuar kete ngaster si are para me se 20 vitesh, kete e shfrytezon edhe paditesit.

Gjykata ne tersi ka aprovuar thenjet e deshmitareve ,nga se te njejt i kane qene te bindeshem kategorik, logjik dhe rrjedhin ne personat te cileve rrethanate kontestuse u jane mirre te njohura dhe asgjë nuk jane vene ne dyshim.

Andaj duke patur parasysh gjendjen faktike siqe eshte peruruar me larte,gjykata ka vertetuar dhe ka konkludua se babaj i paditesit ka blere ngastren e pershkruar me larte nga Vela Vujaqiqi ne vitin 1958 sipas kontrates gojore,e meqense ne dorzimin e posedimit pagesen e cmimit dhe faktin e posedimit shume vjeçare nga babaje i paditesit ,kontrata ne tersi eshte egzekutuar .Meqense paditesit ka aprovuar me sukses bazez juridike te rastit te pronese te babajet te ne palujtshmerin kontestuse, dhe me qene se pa pengese e ka poseduar

dhe shfrytezuar ngastren kontestuse duke hyren ne posedim para me se 20 viteshe gjere ne ditet e sotme, pra eshte ne posedim te kesaj pasurije si posedus i ndergjegjeshem me tepere se 20 vitesh, e qe eshte parapre si kushte i fitimit te pronese me posedim te pasurise se palu-jteshme dhe dispozitat e nenit 28 te Ligjit mbi mardhenjet pronesore-juridike, Gjykata ka vertetuar dhe ka ardhur ne perfundim se paditesi eshte pronare ne baze te posedimit ne pasurine e pershkruar dhe se e paditura pabaze i konteston te drejten pronesore ne te njejten, e ne pajtim me vlersimin te kesaj Gjykate te faktit se siperfaqja kontestuse vetem eshte evidentuar ne omer te paditures nuk nenkupton se eshte prone shoqerore, andaj e paditura eshte e obliguar qe ti njohë te drejten pronesore paditesit ne kete pasuriqe kontestuse siqe eshte pershkruar dhe perfshin ne dispozitive te ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures eshte marur ne baze te k nenit 154 par.1. te LPC, dhe permbane obligimin e te paditures qe paditesit ti kompenzoj shpenzimet meqense paditesi ne tersi ka patur sukse ne kete kontest, e per zhvillimin e ketij kontesti ka pasur dhenje te domosdoshme per takse ne padi dhe vendim dhe shpenzime per ekspertim.

GJYKATA KOMUNALE NE GJLOGOC
C.nr.97/86 te dt.6.10.1988.

Gj y q t a r j a
Jasna Periqi d.v.

KESHILLE JURIDIKE:

Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuara ankesa ne afate prej 15 ditesh, nga dita e marrjes, Gjykates ne Qarkut ne Prishtine, permese kesaj Gjykate ne dy egzemplare.



195/89
17.07.89

Nëpërmjet kësaj dëshmoret se ky dokument është kopje e saktë e origjinalit dhe se përbëhet prej 11 faqesh.
Ovim se potvrđuje da je ova kopija identična sa originalom i sačinjena od stranica.
This is to certify that the document is an exact copy of the original and it is made up of pages

Numri i protokollit / Broj protokola / Protokoll / Data/Dana/Date 15.03.04



Emri i ofiqarit / Ime službenog/lica / Name of the registrar

YE
D

LIFRA
11.11
1989

c.nr.175/89

97/87

NE LINDUR E POPULLIT

Gjykatës Komunalet të Glogocës, në kolegjin e përbe nga gjyqtarët: Danica Marinković, si kryetare e kolegjit, Radmilo Aksentijević e Meleqe Bexheti, si anëtarë të kolegjit në qashtjen juridike të Istref B Bata, nga Glogovci, kundër të paditurit Kamuna e Glogovcit, për vërtetimin e të drejtës pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Glogocë, c.nr.97/86 të dt. 06.tetor 1988, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 14.korrik 1989, marr kësis:

A K T G J Y K I M

VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Glogocë c.nr.97/86 i dt. 8 tetor 1988, ndërsa ankesa e të paditurit si e pabazuar REFUZOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kundërshtuar, dhe atë nën pikën të dispozitivit është miratue kërkesëpapia e paditësit dhe e vërtetue se paditësi është pronar, sipas bazës së mbajtjes së pjesës jugore, i Pk.nr.118 sipas kulturës kulloës e klasës së II në sipërfaqe prej 0,19.000 ha në vendin e quajtur "Eshat - tërqeshtra", gjithë kjo kikatova e as, e cila shtrihet nga veriu në gjatësi 19,6 metra dhe kufizohet me Pk.nr.118 në pronësi shoqërore, në anën e lindjes në gjatësi 101 metër në parcelën e paditësit nr.108/2, në anën jugore në gjatësi prej 18,1 metër ndaj rrugës së fshatit, në anën perëndimore në gjatësi prej 101 ndaj Pk.nr.119 në pronësi të Tabaz L. Korri, dhe i paditari obligohet që këtë të drejtë t'i pranoj, ndërsa nën pikën II të dispozitivit është obligue i paditari që paditësi t'i paguaj shumën prej 23.500 dinarë në emër të kompenzimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore të këtij kontestit në afatin prej 15 ditësh me kërçim të përbarimit.

Kundër aktgjykimit të përmendur në afat ka ushtruar ankesë i paditari, për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar në të drejtë materiale, me propozim si në ankesë.

Duke shqyrtue aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 365 të LFC, Gjykata e kërkuar gjeti se ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Në procedurën e zhvilluar nuk ka shkelje esenciale të dispozitivave të procedurës kontestimore, në të cilat gjykata e kërkuar kujeset sipas detyrës zyrtare, për shkak të të cilave aktgjykimi i kundërshtuar kishte me u prish, e as që i paditari në ankesën e tijë për këto saktësiatë thakson.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara dhe në kuptim të nenit 8 të LPO, drejtë dhe në mënyrë të sigurt, ka vërtetuar gjendjen faktike e cila me pretendimet ankimore nuk vëhet në dyshim.

Në gjendjen e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjyqimit të kundërshtuar për vendimin e sajë ka dhënë arsyetim të rëndësishëm dhe të bazuar të cilin në tërësi e pranon edhe kjo gjykata.

Të pabazuara janë pretendimet ankimore me të cilat aktgjyqimi i shkallës së parë kundërshtohet për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të drejtës materiale.

Me qenese nga ana e gjykatës së shkallës së parë drejtë është vërtetuar se babai i paditësit paluajtëshmëri kontestuese e ka blerë nga Vela Vujaqiq, në vitin 1958, me të cilin paluajtëshmëria kontestuese në fletëposedim na atë kohë është udhëhequr, se babai i paditësit deri me vdekjen e tij është bashku me paditësin e pestaj paditësi deri me sotë paluajtëshmëri kontestuese pandërprerë e mban, se Vela Vujaqiq paluajtëshmëri kontestuese ka fituar në pronësi të njejtën si interesent agrar, gjykata e shkallës së parë drejtë me aktgjykimin e kundërshtuar ka vërtetuar se paditësi është pronari i paluajtëshmërisë kontestuese, sipas bazës së mbajtjes.

I drejtë është vendimi i gjykatës së shkallës së parë mbi shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 368 të I gjykata e çarkut vendosi si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit-gjyqtarj
Danica Marinković, g.v.



TSIN E KOPJES E VIT
I SHKALLËS SË PARË
DREJTË
DANICA MARINKOVIĆ
KRYETARJA



Propozimi i lokacionit në parcelen 140-2 në z.k Qikatovë e Re

Parcela në plan të vitëve 60 është 118-0

70315052-91
70315052-92


70315052-80

70315052-701

70315052-701

Pozicioni i parcelave sipas gjendjes pas zbatimit te mases se komosacionit





Pozicioni i parcelës sipas gjendjes së fotografimit nga viti 1961



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01.400/01 12069 dt. 20 042022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ____04.2022, të aprovoi këtë:

PROPOZIM
VENDIM PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Më këtë propozim vendim, miratohet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2020-2021 në vitin 2022. Mjetet për bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar.

Neni 2

Të hyrat vetanake të pa shpenzuara e që duhet të bartën janë në shumë prej: **1,165,018.04 €** në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe shërbime	423,342.07 €
Subvencione dhe transfere	46,857.50 €
Investime kapitale	694,818.47 €

Neni 3

Shuma e mjeteve për bartje nga neni 2. i këtij Vendimi do të shpenzohet në këto kategori të shpenzimeve dhe në këto programe - nënprograme të komunës:

Mallra dhe Shërbime:

- Shërbimet e Shëndetësisë Primare (730) nën-programi (73100) dhe kod funksional (0721) në kategorinë mallra dhe shërbime (0130), në shumë prej: 29,195.17 €
- Arsimi Parafillor (920) nën-programi(92210) dhe kod funksional (0911) në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve (0130) në shumë prej:..... 37,299.94 €

-Drejtoria për Gjeodezi kadastër dhe Pronë (650) nën-programi (65005) dhe kod funksional (0610) në kategorinë Mallra dhe Shërbime shuma prej	200,882.91 €
Drejtoria e administratës (163) nënprogrami (16301) dhe kod funksional (0133) në kategorinë mallra dhe shërbime shuma prej	155,000.00 €
-Planifikimi Urban dhe mbrojtje të mjedisit (663) nën-programi (66310) dhe kod funksional (0620) në kategorinë mallra dhe shërbime shuma prej.....	1,964.05 €
Gjithsej mallra dhe shërbime.....	424,342.07 €

Subvencione-transfere:

-Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje civile dhe Emergjencë (180) nën-programi(18001) dhe kod funksional (0451) në kategorinë e Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej.....	31,404.20 €
-Drejtorati I Administratës Shëndetësi (730) nën-programi (73010) dhe kod funksional (0760) në kategorinë Subvencione dhe Transfere(200) në shumë prej:.....	11,253.01 €
-Drejtorati për kulturë rini dhe sport (850) nën-programi (85001) me kod funksional (0820) dhe shumë prej:	2, 850.39 €
-Drejtorati I Administratës Arsim (920) nën-programi (92005) dhe kod funksional (0980) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) dhe në shumë prej:	1,349.90 €

Gjithsej Subvencione-transfere..... 46,857.50 €

Shpenzimet Kapitale:

Në programin Shërbimet Publike dhe punë Emergjente (180) nën-programi (18001) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese me kod projekti (49288) dhe shumë prej:.....	2,164.63 €
-Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të SHZSH Gillobar me kod të projektit (47884) dhe shumë prej	736.48 €
-Instalimi i ndriçimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriçimit me kod të projektit (49293) dhe shumë prej	16,571.54 €

Totali i Shërbimeve Publike dhe Punë Emergjente..... 19,472.65 €

Në Programin e Infrastrukturës Publike (181) nën-programi (18161) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Asfaltimi i rrugës Terrsteniku I dhe II me kod të projektit (48633) dhe shumë prej ...	10,102.00 €
-Asfaltimi i rrugës Baicë- Krajkov- Damanek me kod (48640) dhe shuma prej	5,283.32 €
-Kanalizimi i ujërave të zeza Arllat, Negroc, Gjergjic me kod (48703) dhe shumë prej.....	3,703.90 €

-Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza me kod të projektit (48613) dhe shumë prej 100,000.00 €

-Rehabilitimi dhe rekonstruimi i rrugëve me kod të projektit (49188) dhe shuma prej 257,062.31 €

-Rehabilitimi dhe rekonstruimi i kanalizimeve KK Drenas me kod të projektit (49189)) dhe shuma prej..... 100,000.00 €

-Rregullimi i infrastrukturës dhe ndriçimit publik KK Drenas me kod të projektit (48617) dhe shuma prej 75,000.00 €

-Ndërtimi i urave dhe tombinave me kod të projektit (49187) dhe shuma prej..... 50,000.00 €

Totali I infrastrukturës Publike në shumë prej 601,151.53 €

Në programin Shërbimeve Kadastrale dhe punë Gjeodezike (650) nën-programi(65005) dhe kod funksional (0610) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale

-Shpronësimet me kod të projektit (47969) dhe shuma prej 20,000.00 €

Totali Shërbimet katasrale dhe Punë Gjeodezike 20,000.00 €

Në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport (850) nën-programi (85001) dhe kod funksional (0820)do të bartën këto mjete:

-Renovimi i Objekteve Sportive me kod (49182) dhe shumë prej:..... 20,000.00 €

Totali I Kulturës, Rinisë dhe Sportit :.....20,000.00 €

Në programin e Administratës së Arsimit (920) nën-program (92005) do të bartën këto mjete

-Renovimi i Objekteve Shkollore me kod (48240) dhe shumë prej:.....34,194.29 €

Totali I Administratës se Arsimit 34,194.29 €



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 360/01 16102 dt. 13 04 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në vështrim të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), Shkresës Nr.02-907-2/22, të datës 18.03.22 të MAPL-së, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë ____ 04. 2022, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-020/04-8424, të datës 23.02.2022

Neni 1

Më këtë Propozim- Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shfuqizimi i vendimit Nr.02-020/04-8424, të datës 23.02.2022, për formimin e Komisionit për çështjen e banimit të përkohshëm social.

Neni 2

Shfuqizimi i Vendimit Nr.02-020/04-8424, i datës 23.02.2022, i Kuvendit të Komunës së Drenasit, bazohet në Raportin e MPL-së për vlerësimin e ligjshmërisë Nr.02-907-2/22, të datës 18.03.2022.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 23.02.2022 ka aprovuar vendimin Nr.02-020/04-8424, për formimin e komisionit për çështjen e banimit të përkohshëm social, mirëpo pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, sipas shkresës Nr.02-907-2/22, të datës 18.03.2022, është rekomanduar që Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve që konkurojnë për të përfituar nga programet e veçanta të banimit të përcaktohet nga Kryetari i Komunës, gjithahtu ky komision të ketë në përbërje 3-5 anëtarë, kjo bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe në dispozitat e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 22/2010 për procedurat e përfitimit nga Programet e Veçanta për Banim, andaj me qëllim që rekomandimi i MAPL-së të inkorporohet, kërkohet që të aprovohet ky propozim vendim.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllgocit)
Kuvendi i Komunës



02 Nr 020/04-8424 dt. 23.02.2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (“Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës”) nenit 34,pika 34.6,nënpika f të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllgocit) të miratuar në vitin 2008,Programit Komunal tre Vjeçar për Banim, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë, **23.02. 2022**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për çështjet e banimit të përkohshëm social

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni për çështjet e banimit të përkohshëm social në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës si vijon:

1. Albulena Saliuku - anëtar nga kuvendi
2. Jahir Hajdari - anëtar nga kuvendi
3. Florentina Elezi- anëtar nga kuvendi
4. Lumturie Kiqina - anëtar nga ekzekutivi
5. Jeton Prokshi - anëtar nga ekzekutivi
6. Besart Bajrami - anëtar nga ekzekutivi dhe
7. Jetmira Bajrami - përfaqësues nga shoqëria civile

Neni 2

Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e gjendjes ekonomike të familjeve me qëllim të vazhdimit ose ndërprerjes së kontratave, përpilimin e listës përfituese, largimin e familjeve që nuk plotësojnë kriteret dhe çështje tjera të banimit të përkohshëm social.

Neni 3

Komisioni për çështjen e banimit të përkohshëm social në Komunën e Drenasit, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

Neni 4

Ky komision ka për obligim që për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës së Drenasit çdo 6 muaj.

Neni 5

Mandati i këtij komisioni është 3 vjeçar, në përputhje me Programin Komunal për Banim.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

ARSYETIM

Banimi dhe sigurimi i çështjes së banimit të qytetarëve është obligim i komunës. Pra, Komuna merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për të siguruar kullm mbi kokë për vete dhe familjet e tyre. Banimi është çështje vendimtare për një stabilitet social, shëndet të mirë dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore. Vlen të theksohet se e drejta e banimit është njëra ndër të drejtat elementare të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Nr. 03/L-164, ofrohet një kornizë më e avancuar për autoritetet vendimmarrëse lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Edhe Komuna e Drenasit në programet e saj zhvillimore ka për qellim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj, duke mundësuar kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë vështirë të e bëjnë një gjë të tillë.

Përmes krijimit të këtij komisioni synojmë plotësimin e obligimeve ligjore rreth banimit të përkohshëm social, e që puna e tij ndërlidhet ngushtë me përmirësimin e gjendjes ekonomiko-sociale të familjeve që akoma e kanë të pazgjidhur çështjen e banimit.

Duke u nisur nga të gjitha ato që u thanë me lart, do të formohet ky komision.

Vendimi NR.02-020/04-8424 për formimin e komisionit për çështjen e banimit të përkohshëm social, miratuar nga KK Glogoc
I miratuar më datë: 23.02.2022
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.02.2022
I dërguar për shqyrtim në MMPHI më datë: 24.02.2022

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit NR.02-020/04-8424 për formimin e komisionit për çështjen e banimit të përkohshëm social, miratuar nga KK Glogoc, vlerëson se akti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, vlerëson se hyrja e vendimit NR.02-020/04-8424 për formimin e komisionit për çështjen e banimit të përkohshëm social, miratuar nga KK Glogoc, nuk përmban bazën ligjore në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe udhëzimet administrative që rrjedhin nga ky ligj.

Gjithashtu, bazuar në Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe në dispozitat e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga Programet e Veçanta për Banim, parashihet:

Neni 5 - *Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve;*

- 1 *“Kryetari i komunës me vendim përcakton përbërjen dhe kryesuesin e Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve që konkurrojnë për të përfituar nga programet e veçanta të banimit.”*
- 2 *“ Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përbëhet nga 3-5 anëtarë”*

Andaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, akti nuk është në harmoni me nenin 5 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga Programet e Veçanta për Banim, pasi që komisionin për përzgjedhjen e familjeve e përcakton kryetari i komunës dhe nenin 5 paragrafi 2 të të njëjtit udhëzim i cili përcakton se komisioni përbëhet nga tre (3) gjer në pesë (5) anëtarë e jo shtatë (7) anëtarë si janë përcaktuar në aktin komunal.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 035/01 16105 dt. 13.042022

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika I) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 10 paragrafi 2 dhe 5 i Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 , nenin 9 paragrafi 3 dhe 4 i rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrative të akteve të komunave , vendimit të Kuvendit Komunal nr.12/501-13817 të datës 16.03.2016, që është miratuar Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2016 – 2020 ,Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të aprovoi këtë:

POPOZIM VENDIM

Për Revidimin e Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar

Neni 1

Me këtë propozim vendim në përputhje me nenin 10 paragrafi 2 dhe 5 i Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 , kërkohet Revidimi i Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022 , i miratuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunes së Drenasit Nr.12/501-13817 të datës 13.03.2016 për vitet 2016-2020 .

Neni 2

Me hyrjen e këtij vendimi në fuqi shfuqizohet vendimi me Nr. 02-030-8426, i datës 23/02/2022

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjente

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovi

ARSYETIM

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Komunës së Glllogocit është dokument i hartuar në bazë të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave të Republikës së Kosovës dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Objektivat dhe aktivitetet vjetore të planifikuara dhe realizuara në këtë plan raportohen në AMMK (Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës) dhe në MAPL, dhe janë mjaft të rëndësishme për Grantin “Mjedisi i Pastër” dhe atë të “Përformancës komunale”, të cilat vlerësojnë dhe shpërblejnë të arriturat e komunave në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ku komuna nga këto grande vetëm në vitin e kaluar ka fituar mbi 1 milion euro.

Bazuar në planin aktual të menaxhimit të mbeturinave gjatë vitit kalendarik 2021 janë realizuar aktivitete lidhur me përmbushjen e objektivave të planifikuara, por edhe gjatë këtij viti objektivat në planin aktual janë të rëndësishme që të realizohen përmes aktiviteteve, andaj kërkohet që ky plan të jetë i vlefshëm për raportim edhe për vitin kalendarik 2022, deri sa të bëhet hartimi i Planit të ri.

